

**HAMIT KABA**

**“VATRA” DHE “SHQIPËRIA E LIRË”  
NË DY PERIUDHA KTHESASH  
(1941-1946)**

Komuniteti shqiptar i Amerikës jeton në një shtet me demokraci të zhvilluar, politika e të cilit ka qenë e favorshme për Shqipërinë, veçanërisht në disa momente kyçe të historisë së shqiptarëve. Organizatat e diasporës shqiptare në SHBA, veçanërisht “Vatra” dhe më pak “Shqipëria e Lirë” zënë një vend të veçantë në historinë e periudhës që po trajtojmë. Kjo, jo thjesht për numrin e të mërguarve shqiptarë të grupuar rreth tyre, por për angazhimin e spikatur për çështjen kombëtare dhe ndaj problemeve të mëdha, me të cilat u përball kombi shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe në mbarim të saj. Duke filluar nga mesi i vitit 1941, “Vatra” ashtu edhe “Shqipëria e Lirë” (pas krijimit të saj në dhjetor 1941), kanë zhvilluar një aktivitet intensiv brenda radhëve të komunitetit shqiptar në SHBA, por edhe tek qeveritë e Aleatëve të Mëdhenj (SHBA, Britania e Madhe dhe Bashkimi Sovjetik), duke u përballur me sfidat që kishin të bënin me njohjen e Shqipërisë si vend aleat, me të ardhmen e shtetit shqiptar të Pasluftës dhe ruajtjen e tërësisë së tij territoriale. Në funksion të këtij qëllimi “Vatra” dhe “Shqipëria e Lirë” bënë përpjekje për të afirmuar faktorin shqiptar tek qeveritë e vendeve të mëdha aleate, dhe për të marrë prej tyre garancitë e nevojshme për të ardhmen e vendit pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Por faktori shqiptar në Amerikë nuk ishte i unifikuar. “Vatra” me Konicën e Nolin mbështetën idenë e krijimit dhe njohjes së një qeverie shqiptare në emigracion të kryesuar nga Zogu, ndërsa “Shqipëria e Lirë” me Konstandin Çekrezin e Tajar Zavalanin qenë kundër saj. Përpjekjet për t’u marrë vesh ndërmjet tyre, ndonëse nuk munguan përfunduan pa sukses. Përçarja e faktorit shqiptar, si jashtë, ashtu edhe brenda Shqipërisë, mosnjohja e një qeverie shqiptare në emigracion nga qeveritë e tre Aleatëve të Mëdhenj dhe pretendimet greke ndaj territoreve jugore të Shqipërisë e megjulluan të ardhmen e saj.

Duke filluar nga verë-vjeshta e vitit 1944, në rrethana të brendshme e të jashtme të ndryshuara, si “Vatra”, ashtu edhe “Shqipëria e Lirë”

mbështetën qeveritë e Frontit Nacionalçlirimtar (të dala nga Kongresi i Përmetit dhe Mbledhja e Beratit) dhe kërkesat për t'u njohur nga qeveritë e SHBA, Britanisë së Madhe dhe BRSS, pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara, ruajtjen e tërësisë së saj territoriale etj.

Në veprimtarinë e mërgimtarëve shqiptarë në SHBA, të atashuar pranë “Vatrës” dhe të “Shqipërisë së Lirë” ndërthuren aspekte të ndryshme me karakter kulturor, social e politik. Artikulli fokusohet tek historia e tyre politike.

### 1. “Vatra” dhe “Shqipëria e Lirë” (1941-1944)

Vatra dhe udhëheqësit kryesorë të saj, Konica dhe Noli<sup>1</sup>, ndonëse e dënuan pushtimin e Shqipërisë nga Italia, patën një periudhë pasiviteti në veprimtarinë e tyre politike<sup>2</sup>. Italianët u munduan që nëpërmjet “Vatrës” dhe gazetës “Dielli” të ndikonin tek komuniteti shqiptaro-amerikan për të siguruar mbështetjen e tyre.<sup>3</sup> Në fakt aktiviteti politik i “Vatrës” dhe numri i anëtarësisë së saj ishin tkurrur më herët, duke filluar që nga viti 1926. “Vatra” ishte përçarë dhe kishte marrë karakterin e një organizate jo politike, por thjesht me funksione arsimore e mirëbërëse.<sup>4</sup> Aktiviteti politik i “Vatrës” në mbështetje të çështjes kombëtare filloi të rritej sërish, pas hyrjes së SHBA në luftë, pas krijimit të organizatës së re dhe shumë aktive “Shqipëria e Lirë”, nga Konstandin Çekrezi në dhjetor 1941<sup>5</sup> dhe, sidomos pas alarmit të shkaktuar nga kërkesat greke për Shqipërinë e Jugut, të shprehura zyrtarisht nga qeveria greke në

<sup>1</sup> Duke filluar nga viti 1932, F. S. Noli në SHBA kishte hequr dorë nga veprimtaria politike. Ai njihej si peshkopi i Kishës Ortodokse të shqiptarëve të Amerikës. Pas vdekjes së Faik Konicës në dhjetor 1942, drejtues i “Vatrës” u zgjodh Vasil Pani, ndërsa Noli kryetar nderi i saj. Statusi honorifik nuk e ndaloi Nolin të mbetej në fakt deri në vdekjen e tij drejtues i vërtetë i “Vatrës”.

<sup>2</sup> Ilir Ikonimi, *Faik Konica. Jeta dhe vepra në Uashington*, Tiranë: “Onufri”, 2011, f. 297.

<sup>3</sup> *The National Archives and Record Administration* (më tej: NARA), 875.O1./IO-3144, Informacion i z. B.O. Konica për Sekretarin e Shtetit, 31 tetor 1944.

<sup>4</sup> NARA, RG 226, 21485, *Memorandum: Albanian Politics in the United States*, 25 shtator 1942; I. Ikonimi, *Faik Konica ...*, f. 297.

<sup>5</sup> *Po aty*, RG 226, Programi Politik Kombëtar i “Shqipërisë së Lirë”, Boston, Mass., 27-28 dhjetor 1941.

emigracion<sup>6</sup> dhe organizatat e ndryshme greke brenda dhe jashtë SHBA. Momente reflektimi dhe angazhimi për komunitetin shqiptar të Amerikës shënuan në veçanti dalja e Kartës së Atlantikut në gusht 1941, deklarata e Kombeve të Bashkuara në janar të vitit 1942, dhe sidomos deklaratat e tre ministrave të Jashtëm të Fuqive të Mëdha Aleate, përkatësisht të Hull, Eden dhe Molotov në dhjetor 1942, në lidhje me ringritjen e shtetit të pavarur shqiptar pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore.

Krerët e “Vatrës” dhe “Shqipërisë së Lirë” ndoqën me kujdes politikën e Aleatëve të Mëdhenj për Shqipërinë, veçanërisht atë amerikane e britanike, duke shfrytëzuar mundësitë e krijuara për të ardhmen e shtetit shqiptar pas LDB. Por, politika amerikane në lidhje me Shqipërinë dhe të ardhmen e saj në vijat e saj kryesore eci në të njëjtën rrugë me atë të Britanisë së Madhe dhe, në njëfarë mase edhe me atë të aleatit lindor, Bashkimit Sovjetik. Na duhet të theksojmë një mendim tashmë të pranuar se, Ballkani ishte një rajon ku SHBA nuk kishin interesa vitale dhe Shqipëria nuk përbënte ndonjë përjashtim nga ky rregull.<sup>7</sup> Departamenti i Shtetit, në një letër që i përcillte Foreign Office (FO) në shkurt 1942 bënte të ditur, se qeveria amerikane nuk e kishte angazhuar veten me Mbretin Zog apo ndonjë lider tjetër shqiptar, se ajo nuk kishte ndonjë ide paraprake për statusin e ardhshëm të Shqipërisë së Pasluftës. Më tej e njoftonte FO se kërkesën e marrë nga Mbreti Zog për aderimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara, ai e konsideronte si jo angazhuese dhe pa ndonjë rëndësi politike.<sup>8</sup> Shqipëria nuk ishte përfshirë në listën e vendeve që përfitonin mbështetje nga programi amerikan i ndihmave gjatë Luftës së Dytë Botërore, i njohur si akti “Land Lease” [huadhënie]<sup>9</sup>. Pavarësisht nga këto kufizime, SHBA e mbështetën rezistencën e shqiptarëve gjatë LDB dhe kontribuan në çlirimin e Shqipërisë, përmes dërgimit atje të një misioni të posaçëm, të varur nga Zyra e Shërbimeve Strategjike (Office of Strategic Services-OSS). Nga

<sup>6</sup> *Po aty*, RG 226, 75908, *Albania under German Occupation*, 12 qershor 1944, p. 9, përgatitur nga Stavro Skëndi.

<sup>7</sup> Geri Lundenstad, *The American Non Policy Towards Eastern Europe, 1943-1947* (Tromoso u. a.: 1978), p. 96; Roderick Baily, *OSS-SOE Relations, Albania 1943-1944*, Intelligence and National Security, vol. 15, no.2, Oxford: 2000, p. 20.

<sup>8</sup> *The National Archives, London* (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/33107, 1942.

<sup>9</sup> Hamit Kaba, “Qëndrimi amerikan ndaj Shqipërisë në vitet e rezistencës, 1943-1944”, *Studime historike*, 3-4, Tiranë: 2009, f. 71.

ana e saj, qeveria britanike, ndonëse i dha strehim Mbretit Zog, nuk e njohu atë si përfaqësues legjitim të Shqipërisë, sikurse veptoi me qeveritë mbretërore greke e jugosllave në emigracion, por thjesht si person privat. Britania e Madhe, sikurse edhe SHBA nuk e pranuan idenë e krijimit të një qeverie të kryesuar nga Zogu në emigracion, sikurse edhe njohjen e saj si vend anëtar i kombeve antifashiste. Britania e Madhe ishte padyshim shteti më i interesuar për rajonin e Ballkanit dhe të ardhmen e tij pas LDB. Por, krahasuar me dy vendet fqinje, Greqinë dhe Jugosllavinë, Shqipëria ishte vendi më pak i rëndësishëm për interesat britanike. Interesat prioritare britanike ndaj dy shteteve të mësipërme, peshë e kufizuar e rezistencës antifashiste të shqiptarëve krahasur me atë të popujve grek e jugosllav u materializuan qartazi gjatë LDB.

Njohja më e imët e dokumentacionit arkivor amerikan e britanik të çon në përfundimin se në politikën e SHBA e Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë, pavarësisht nga ngjashmëritë, kanë pasur edhe disa ndryshime, të cilat janë vënë në dukje nga vetë diplomatët e dy vendeve. Unë do të përmend dy momente të rëndësishme: së pari, deklaratën e butë, të bërë nga Sekretari Amerikan i Shtetit, Hull, më 8 prill 1939, e cila nuk e njihte pushtimin italian të Shqipërisë<sup>10</sup>, ndërkohë që qeveria britanike e njohu atë, dhe së dyti, diferencat ndërmjet deklaratave të bëra nga Hull më 10 dhjetor 1942 dhe nga kolegu i tij britanik Eden, 7 ditë më vonë në Dhomën e Komuneve, në lidhje me të ardhmen e shtetit shqiptar të Pasluftës.<sup>11</sup>

Të dyja organizatat e shqiptarëve të Amerikës, si “Vatra” ashtu edhe “Shqipëria e Lirë” patën kontakte me Departamentin e Shtetit për probleme që lidheshin me të ardhmen e vendit të origjinës-Shqipërisë, përmes takimeve direkte apo përmes letërkëmbimit. Marrëdhëniet e komunitetit shqiptar të Amerikës, të grupuar rreth “Vatrës” dhe “Shqipërisë së Lirë” kanë pasur pika bashkimi edhe ndarjeje. Të dyja organizatat i kundërshtuan fort kërkesat greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut; u solidarizuan me Kartën e Atlantikut; paraqitën kërkesa për përfshirjen e Shqipërisë në radhët e kombeve që firmosën Deklaratën e Kombeve të Bashkuara; shprehën gjithashtu pakënaqësitë e tyre për

---

<sup>10</sup> *Peace and War: United States Foreign Policy, 1931-1941*, Washington, D.C.: Government Printing Office, 1943, p. 454;

<http://WWW.motholyoke.edu/acad/intrel/WorWar2/albania.html>

<sup>11</sup> Beqir Meta, *Tensioni greko-shqiptar (1939-1949)*, Tiranë: “Geer”, 2002, f. 99; TNA, FO 371/33107, 1942, p. 57.

deklaratën britanike të dhjetorit të vitit 1942 etj. Mosmarrëveshja kryesore ndërmjet tyre erdhi për shkak të qëndrimit të ndryshëm të mbajtur ndaj idesë së krijimit dhe mbështetjes së një qeverie shqiptare në mërgim. “Vatra” mbështeti idenë e një qeverie të kryesuar nga Zogu<sup>12</sup>, ndërkohë që “Shqipëria e Lirë” e kundërshtonte në mënyrë të vendosur këtë ide.

Më 24 janar 1942, Zogu i paraqiti ish ministrit britanik në Tiranë, Rayan, idenë e krijimit të një kabineti me 4 ose 5 anëtarë, një trup të vogël përfaqësuesish të zgjedhur nga kolonitë shqiptare në SHBA, Turqi e Egjipt, të cilën, ai zotohej ta financonte gjatë dy viteve të para të krijimit të saj<sup>13</sup>. Fillimisht ideja e Zogut u përqafua nga Faik Konica dhe pastaj nga Noli, dy nga figurat më të spikatura të shqiptarëve të Amerikës dhe njëkohësisht ish-kundërshtarë të Zogut, e cila u zyrtarizua nga kuvendi i “Vatrës” në korrik 1942<sup>14</sup>. Ndërsa Çekrezi si drejtues i “Shqipërisë së Lirë” kishte qëllime më ambicioze dhe objektiva më të mëdha, të cilat ishin legjitimuar në Kongresin e saj, të mbajtur në Boston, më 27-28 dhjetor 1941<sup>15</sup>. Programi politik prej 5 pikash i “Shqipërisë së Lirë” parashikonte të tërhiqte rreth saj të gjithë shqiptarët e mërgimit; të garantonte të drejtat e kombit shqiptar, duke bashkëpunuar me qeverinë amerikane dhe aleatët e saj - Anglinë dhe Rusinë; të krijonte lidhje me elementë që zhvillonin rezistencën në Shqipëri dhe së fundi, të përgatiste plane për rindërtimin mbi baza demokratike të shtetit shqiptar të Pasluftës. Objektivi i fundit do të realizohej përmes një qeverie të dalë nga populli, “duke përjashtuar të gjithë ata që duan të bëhen mbretër, princër, diktatorë dhe shtypës të popullit”.<sup>16</sup> “Shqipëria e Lirë” e prezantonte veten si një qeveri në mërgim për mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë, gjer në ditën kur populli shqiptar do të ishte në gjendje të kishte qeverinë e tij kombëtare, të zgjedhur lirisht prej tij. Pas përmbushjes së këtij objektivi “Shqipëria e Lirë” do të transferohej në “parti politike me program liberal, demokratik e popullor”.<sup>17</sup> Programi i “Shqipërisë së Lirë” e përjashtonte ekzistencën e një qeverie nën Zogun,

<sup>12</sup> I. Ikononi, *Faik Konica...*, f. 298.

<sup>13</sup> TNA, FO 371/33110, p. 86.

<sup>14</sup> NARA, RG 226, 22104, 12 tetor 1942.

<sup>15</sup> *Po aty*, RG 226, “Përse u ngreh Shqipëria e Lirë? Cili është programi i saj politik e kombëtar?” Boston, Mass.”, 27-28 dhjetor 1941.

<sup>16</sup> *Po aty*.

<sup>17</sup> *Po aty*.

për të cilin shprehej se “populli shqiptar e meriton një fat shumë më të mirë nga ay, në të cilin e shpuri regjimi i Zogut”.<sup>18</sup> Në dallim nga “Vatra”, “Shqipëria e Lirë” u kushtoi vëmendje zhvillimeve të brendshme në Shqipëri, duke i hapur rrugën krijimit të një qeverie të ardhshme brenda vendit. Ajo e konsideroi këtë si një problem parimor, ndaj të cilit nuk ndryshoi qëndrim, pavarësisht nga disa lëkundje të kushtëzuara të saj. Vendimi i “Vatrës” dhe krerëve të saj, Konicës e Nolit për të mbështetur idenë e një qeverie apo Fronti të Bashkuar Kombëtar të shqiptarëve në emigracion të kryesuar nga Zogu, nuk gjeti mbështetje tek asnjëra prej qeverive aleate<sup>19</sup>. Ky qëndrim i tyre u formësua nën ndikimin e fortë të Britanisë së Madhe<sup>20</sup>, e cila ishte fuqia më e interesuar për Shqipërinë në këto vite, si edhe e mungesës së interesit të SHBA dhe Bashkimit Sovjetik për Shqipërinë.

Ndryshimi i qëndrimit të Nolit ndaj Zogut u komentua si “rënie nën magjinë e Faik Konicës”<sup>21</sup> dhe shkaktoi një farë reaksioni ndaj tij tek një pjesë e vatanëve. Përfaqësues të dy organizatave të emigrantëve shqiptarë në SHBA u munduan të sheshonin mosmarrëveshjet për të arritur në një zgjidhje të pranuar nga të dy palët, por pa sukses.<sup>22</sup> Çekrezi pretendonte se “Shqipëria e Lirë” do të njihej nga qeveria amerikane, gjë që nuk u realizua ndonjëherë, ndërsa akuzonte palën tjetër se ajo mbështetej tek Britania e Madhe, e cila nuk e njihte Zogun dhe, u kishte bërë premtime Greqisë e Jugosllavisë, se do t’i kompensonte pas mbarimit të Luftës me territore shqiptare.<sup>23</sup>

Sipas Nolit, as SHBA dhe as Britania e Madhe nuk e kishin angazhuar veten me çështjen shqiptare, kështu që ai preferonte të mbështeste Zogun.<sup>24</sup> Vetë Zogu ishte në dijeni të Kartës së Atlantikut dhe e kishte përshëndetur daljen e saj. Zogu u ishte shprehur përfaqësuesve të

<sup>18</sup> *Po aty*.

<sup>19</sup> *Po aty*, RG 226, 21485, *Memorandum: Albanian Politics in the United States*, Sekret, 25 shtator 1942; TNA, FO 371/33107, 13 janar 1942.

<sup>20</sup> B. Meta, *Tensioni greko-shqiptar...*, f. 363-367.

<sup>21</sup> NARA, RG 226, OSS, *A New Albanian Movement*, 31 gusht 1942.

<sup>22</sup> *Po aty*, OSS, *Memorandum: Albanian Politics in the United States*, 2 nëntor 1942; B. Meta, *Tensioni greko-shqiptar...*, f. 369.

<sup>23</sup> *Po aty*, RG 226, *Memorandum i OSS, Albanian Politics in the United States*, 25 shtator 1942.

<sup>24</sup> *Po aty*, RG 226, *Memorandum i OSS: Albanian Politics in the United States*, 12 tetor 1942.

Komitetit Ballkanik në Londër, Robert Hodgson dhe gjeneral Jocelyn Percy se menjëherë pas kryerjes së çlirimit të vendit të tij, ai do t'i jepte popullit shqiptar mundësinë që të gjykonte vetë për formën e kushtetutës që dëshironte, dhe se ai do t'i lejonte atë të vendoste vet, nëse donte republikë, monarki, apo ndonjë formë tjetër qeverisjeje<sup>25</sup>.

Përdorimi i legjitimitetit të Zogut dhe i figurës së tij nga ana e “Vatrës”, për të prezantuar tek qeveritë e Aleatëve të Mëdhenj çështjen shqiptare gjatë kohës së luftës, ishte një politikë e mençur dhe e urtë. Mbështetja që iu dha Zogut, pavarësisht mosnjohjes së tij nga qeveritë aleate, nuk ishte as në kundërshtim me Kartën e Atlantikut (gusht 1941) dhe as me deklaratat e shpallura nga qeveritë e Britanisë së Madhe, SHBA dhe BRSS në dhjetor 1942. Këto të fundit pranonin ekzistencën e një shteti të pavarur shqiptar pas luftës dhe mbështesnin idenë, se do të ishte populli shqiptar ai që do të përcaktonte formën e qeverisjes dhe do të zgjidhte qeverinë që dëshironte. Kjo formulë e adoptuar nga aleatët nuk e përjashtonte Zogun nga konkurimi, sikurse nuk i jepte atij pozicionin e privilegjuar ndër konkurrentët e tjerë. Pranimi i Kartës së Atlantikut dhe Deklaratës së Kombeve të Bashkuara presupozonte një “garë” të hapur për formën e qeverisjes dhe qeverinë e çdo kombi antifashist. Si të tilla, së paku teorikisht, ato e linin të hapur rrugën në zgjedhjet e pasluftës, qoftë për Zogun, ashtu edhe për forcat e tjera pretenduese për pushtet në Shqipëri. Kjo formulë u zbatua edhe për Jugosllavinë e Greqinë e pas luftës, pavarësisht se qeveritë e Britanisë së Madhe dhe SHBA i kishin njohur qeveritë e tyre mbretërore në emigracion gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në fokusin e sulmeve, “Shqipëria e Lirë” vendosi sidomos Faik Konicën, i dalluar për kritikën e mëparshme therëse dhe me shumë kolorit kundër Zogut. Konstandin Çekrezi dhe miqtë e tij në Londër, T. Zavalani, D. Duma, A. Logoreci e Çatin Saraçi shkruan disa artikuj kundër tij. Në përgjigje të kritikave të adresuara ndaj tij, Faik Konica do të përgjigjej: “Nuk do të ketë Shqipëri, nëse shqiptarët nuk vendosin interesat kombëtare mbi zilitë personale”.<sup>26</sup> Lufta politike ndërmjet “Vatrës” dhe “Shqipërisë së Lirë” nuk kaloi pa pasoja edhe për këtë të fundit. Brenda

<sup>25</sup> *Po aty*, RG 226, Memorandum i Edward Boyle, President i Komitetit Ballkanik për OSS, 2 korrik, 1942.

<sup>26</sup> *TNA*, FO 371/33111, Përgjigje e Faik Konicës nga Washingtoni drejtuar Çatin Saraçit, më 11 dhjetor 1942.

saj pati lëkundje e largime anëtarësh. Imazhi i Konstandin Çekrezit si drejtues pati një farë zverdhjeje dhe grryerje brenda kësaj organizate<sup>27</sup>. Situata u lehtësua disi në vjeshtë 1942, kur Tajar Zavalani u zgjodh si zëvendës president i “Shqipërisë së Lirë” dhe si botues i gazetës së saj “Liria”. Disa artikuj të tij në këtë gazetë do ta përmirësonin gjendjen e organizatës.

Qeveritë e SHBA dhe Britanisë së Madhe, jo vetëm që nuk miratuan e mbështetën idenë e krijimit të një qeverie shqiptare në emigracion, me Zogun si figurë qendrore, por nuk njohën asnjë nga dy organizatat e shqiptarëve në SHBA, nuk i miratuan kërkesat e tyre e të Zogut për t’u bashkuar me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara, e cila do të legjitimonte ekzistencën e Shqipërisë si shtet aleat etj. Noli, ndonëse e refuzoi ftesën e Zogut për të qenë ai kryeministër i qeverisë në mërgim e mbështeti pa mëdyshje opsionin e një qeverie të kryesuar nga Zogu, gjatë një periudhe 3 vjeçare. Noli theksonte: “kam pasur rast t’u them disa zyrtarëve në Washington, se mbreti Zog është i aftë të bëjë për Aleatët më shumë se sa ndonjë shqiptar tjetër, apo ndonjë grup shqiptarësh, pavarësisht nga zhurmat që disa kundërshtarë të tij, po bëjnë në Washington e Londër”<sup>28</sup>.

Faiku dhe sidomos Noli kanë zhvilluar disa takime me zyrtarë të Departamentit të Shtetit dhe i kanë shkruar disa herë këtij institucioni, apo personaliteteve të larta të shtetit amerikan, lidhur me kërkesat e shqiptarëve të Amerikës, sidomos për të njohur një qeveri të kryesuar nga Zogu në emigracion<sup>29</sup>. Për politikën amerikane nuk ekzistonte ndonjë qeveri shqiptare e njohur nga Kombet Aleate, se shqiptarët ishin prerazi të ndarë në fraksione pro e kundër Zogut ...<sup>30</sup>.

Federata “Vatra” dhe degët e saj në SHBA, si dhe “Shqipëria e Lirë” reagues fort ndaj deklaratës së qeverisë britanike të dhjetorit 1942, e cila e linte të hapur problemin e kufijve të Shqipërisë. Në një telegram me terma të zgjedhura, drejtuar Cordell Hull, të botuar edhe në gazetën “Dielli”, Noli do të nënvizonte: së pari, qëndrimin pozitiv të mbajtur nga

<sup>27</sup> NARA, RG 226, Memorandum: *Albanian Politics in the United States*, 25 shtator 1942.

<sup>28</sup> *Po aty*, RG 226, Memorandum: *Albanian Politics in the United States*, 12 tetor 1942.

<sup>29</sup> B. Meta, *Tensioni greko-shqiptar...*, f.375; I. Ikonimi, *Faik Konica...*, f. 313-314.

<sup>30</sup> TNA, FO 371/37138, 12 janar 1943, p. 6.

Turqia dhe Egjipti, të cilat nuk e njohën aneksimin e Shqipërisë nga Italia; së dyti, kërkesën për të njohur një qeveri shqiptare në mërgim, të kryesuar nga Zogu; së treti, pranimin zyrtar të qeverisë së Zogut në Kombet e Bashkuara, dhe së fundi, ai kërkoi të garantohej se në Konferencën e ardhshme të Paqes nuk do të cenoheshin kufijtë e Shqipërisë<sup>31</sup>. Çështja shqiptare u mbështet gjithashtu edhe nga Komiteti Ballkanik, nga miqtë amerikanë e britanikë të Shqipërisë etj. Si Zogu<sup>32</sup> ashtu edhe Konica e kundërshtuan idenë e Komitetit Ballkanik, sipas të cilit SHBA do të kishin mandatin mbi Shqipërinë pas LDB. Konica do ta kundërshtonte këtë ide duke e konsideruar atë parimisht të gabuar, pavarësisht nga besimi që ai kishte tek SHBA. Ai do të vinte theksin tek aftësitë qeverisëse të shqiptarëve, të dëshmuara sidomos me 35 kryeministrat shqiptarë që qeverisën Perandorisë Osmane, tek referenca e studiuesit të njohur Henry A.L. Fisher në Univeristitetit të Oxfordit etj., Konica shprehej se “nuk është Shqipëria, por Greqia që ka nevojë për një mandat”<sup>33</sup>. Ideja e një mandati amerikan apo britanik mbi Shqipërinë ndeshet jo rrallë në dokumentacionin e arkivave britanike. Kjo ide u pranua edhe nga Dervish Duma, i cili në një letër që i dërgonte Konicës në janar 1942, shprehej: “Kjo, për një kohë mund të jetë rruga më e mirë, për të na ruajtur neve [shqiptarët] nga vetvetja dhe nga fqinjët tanë”<sup>34</sup>.

Noli pati kontakte me sekretarin e Komitetit Ballkanik, Edward Boyle dhe mbështeti idenë e krijimit të një Fronti të Bashkuar Shqiptar nën udhëheqjen e Zogut, e cila u refuzua nga qeveria britanike<sup>35</sup>. Mbështetja që Noli i dha idesë së krijimit të një qeverie shqiptare në emigracion, ku figurë qendrore të ishte Zogu është shpjeguar në mënyra të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Bernd Fisher, ndonëse ka nënvizuar prirjet demokratike perëndimore të qeverisë së Nolit të vitit 1924, rolin e tij si themelues i Kishës Ortodokse Shqiptare në SHBA dhe të qenit njeri me parime, qëndrimin e tij ndaj Zogut në vitet e Luftës së Dytë Botërore

<sup>31</sup> *Po aty*.

<sup>32</sup> TNA, FO 371/33109, p.66, Nga takimi i Zogut me A. Rayan, më 25 korrik 1942.

<sup>33</sup> NARA, RG 226, Memorandum i OSS, 25 shtator 1942.

<sup>34</sup> Faik Konitza, *Selected Correspondence (1896-1942)*, London: The Center for Albanian Studies, 2000, p. 116.

<sup>35</sup> NARA, RG 226, A New Albanian Movement, 26 gusht 1942.

e shpjegon me pagesën e përfituar nga Zogu dhe pragmatizmin e tij.<sup>36</sup> Ndërsa studiuesi Beqir Meta sheh tek Zogu një person, i cili do ta shfrytëzonte njohjen e qeverisë shqiptare nga Aleatët e Mëdhenj të luftës, si një mundësi reale për të ndaluar gëlltitjen e territoreve shqiptare nga shtetet fqinje dhe mënjanimin e një çrregullimi të brendshëm<sup>37</sup>. Noli dhe shqiptarët e moderuar në SHBA preferuan që të kishin një Shqipëri të pavarur qoftë edhe nën Zogun, të njohur nga Aleatët, një shtet që do të përfaqësohej në Konferencën e ardhshme të Paqes për të mbrojtur të drejtat e tij. Në këtë sens qëndrimi i Nolit ndaj Zogut ishte i drejtë, patriotik dhe i kushtëzuar nga rrethanat, që e bënin të domosdoshëm bashkimin e shqiptarëve për të përballuar rreziqe, të cilat nuk ishin as të reja dhe as të panjohura për ata. Noli nuk e pranoi propozimin për të qenë ai në krye të një qeverie apo të një Komiteti Kombëtar në emigracion, duke u justifikuar se ai ishte qytetar amerikan. Njohja e Zogut si udhëheqës kombëtar i shqiptarëve nga “Vatra” u kushtëzua me pranimin prej tij të parimit, se pas çlirimit të Shqipërisë do ishte populli shqiptar ai që do të vendoste për formën e regjimit<sup>38</sup>. Vetë Zogu do ta vlerësonte figurën e Nolit, ndonëse kohë më parë e kishin dënuar njeri-tjetrin me vdekje, duke e karakterizuar atë si një person “shumë inteligjent”<sup>39</sup>. Noli ishte ndër të paktët politikanë shqiptarë që e ndërtonte politikën mbi bazën e parimeve dhe dinjitetit. Noli ishte gjithashtu një urë lidhëse ndërmjet shqiptarëve në emigracion, një njeri me ndikim të madh tek shqiptarët e besimeve të ndryshme, një njeri i respektuar edhe nga personat me bindje të tjera politike, jo vetëm gjatë luftës por deri sa vdiq. Në një letër që studenti shqiptar i Harvard-it dhe më vonë diplomat amerikan në Departamentin e Shtetit, Stivën Pitërs (Stephen Peters), i dërgonte Milto Noçkës më 8 nëntor 1942, vinte në dyshim frytshmërinë e ardhjes së Tajar Zavalanit në SHBA si editor i gazetës “Liria”. Ai shkruante: “E vërteta është se asnjë njeri që nuk bashkëpunon me imzot Nolin, nuk mund të ketë pranonjës këtu. 90% janë pas Nolit. Kur ay u thotë shqiptarëve këtu se Zogu është i nevojshëm për bashkimin

<sup>36</sup> Bernd Fischer, *Shqipëria gjatë Luftës (1939-1945)*, Tiranë: “Çabej”, 1999, f. 314.

<sup>37</sup> B. Meta, *Tensioni greko-shqiptar...*, f. 119.

<sup>38</sup> TNA, (War Office) WO 204/0962, Volume 4 (M-R), Handbook of Albanian Personalities, maj 1945.

<sup>39</sup> *Po aty*, FO 371/33110, p. 143, Nga intervista e A. Rayan me Zogun, më 25 korrik 1942.

kombëtar ata e vënë në vesh fjalën e tij, dhe as Tajari [Zavalani] e as njeri tjetër nuk mund t’ua kthejnë mendjen”.<sup>40</sup>

Përpjekjet e shqiptarëve në emigracion për të krijuar një Front të Bashkuar, si kusht paraprak për njohjen nga qeveritë aleate të Zogut, vazhduan edhe në vitin 1944. Në maj-qershor 1944 në Londër janë zhvilluar disa takime sekrete ndërmjet disa personave të autorizuar nga Zogu, dhe “Shqipërisë së Lirë”, të përfaqësuar nga Tajari Zavalani, Anton Logareci dhe Dervish Duma.<sup>41</sup> Nga përmbajtja e dokumenteve duket se, organizata “Shqipëria e Lirë” e kishte pranuar idenë e krijimit të një Komiteti Kombëtar me në krye Zogun, por kishte vendosur dy kushte: së pari, që Zogu të pranonte të qëndronte jashtë Shqipërisë deri në kohën e përfundimit të një plebishiti pas luftës, i cili do të përcaktonte formën e regjimit në Shqipëri, dhe së dyti, të pranonte ardhjen e menjëhershme të përfaqësuesve nga Shqipëria në Londër, për t’u bashkuar me Komitetin Kombëtar që do të krijohet.<sup>42</sup> Këto kushte nuk u pranuan nga përfaqësuesit e Zogut dhe, mosmarrëveshjet ndërmjet fraksioneve në emigracion vazhduan si më parë.

Më 26 maj 1944 në një bisedë të zhvilluar në Shtëpinë e Bardhë, interesit të presidentit Rusvelt [Franklin Delano Roosevelt] për të ditur motivet se pse Shqipëria nuk ftohej në konferencat e fundit ndërkombëtare, Din Acheson [Dean Acheson – Ndihmës Sekretar i Shtetit] do t’u përgjigjej se, “që nga viti 1939 nuk ka pasur ndonjë autoritet shqiptar jashtë vendit, që të prezantonte mjaftueshëm forcat e rezistencës brenda vendit, ose të unifikonte grupet shqiptare jashtë tij”<sup>43</sup>. “Qeveria e fundit, shtonte ai më tej, duhet të konsiderohet e pezulluar dhe se grindjet dhe përçarjet i kishin penguar mërgimtarët e tjerë, të formonin ndonjë grup me karakter përfaqësues. Për fat të keq, ndërmjet patriotëve brenda vendit ka një mungesë të theksuar uniteti”<sup>44</sup>. Përfaqësues të rëndësishëm në Departamentin Amerikan të Shtetit e kishin këshilluar

<sup>40</sup> *Po aty*, FO 371/33109, p. 150.

<sup>41</sup> NARA, RG 226, Mungesa e Marrëveshjes ndërmjet zogistëve dhe antizogistëve, 7 korrik 1944.

<sup>42</sup> *Po aty*.

<sup>43</sup> *Foreign Relations of the United States of America* (më tej: *FRUS*), *Diplomatic Papers 1944*, Volume III, *The British Commonwealth and Europe*, Washington: 1965, p. 6-7, Memorandum nga Sekretari i Shtetit (Cordell Hull) për Presidentin Rusvelt, Washington, 27 maj 1944.

<sup>44</sup> *Po aty*.

Çekrezin në korrik 1942, që me organizatën që ai drejtonte dhe “Vatrën”, të krijonte një front të përbashkët, por tentativat nuk rezultuan të suksesshme<sup>45</sup>. SHBA refuzuan gjithashtu të njihnin qeverinë e dalë nga Kongresi i Përmetit dhe Mbledhja e Beratit. “Ne, i shkruante sekretari Amerikan i Shtetit, konsullit të përgjithshëm amerikan në Napoli, më 20 korrik 1944, favorizojmë formimin eventual të një qeverie të përkohshme në Shqipërinë e lirë, që përfaqëson dëshirat e popullit, pa shtruar në këtë kohë çështjen e statusit të mbretit Zog dhe pa treguar interes të veçantë ndaj ideve politike të ndonjë grupi tanimë aktiv”<sup>46</sup>.

Pavarësisht nga sugjerimet e qeverisë amerikane dhe përpjekjet e “Vatrës” për të unifikuar faktorin shqiptar në emigracion, ai mbeti i përcarë dhe i pakoordinuar me faktorin e brendshëm. Në shtator të vitit 1944 prestigji i Zogut brenda vendit kishte filluar të perëndonte, ndërkohë që ishte rritur në mënyrë të konsiderueshme në qarqet jashtë tij<sup>47</sup>. Kjo situatë duhet parë e lidhur ngushtë me vendimin e marrë nga Kongresi i Përmetit, i cili e ndalonte kthimin e Zogut në Shqipëri, të supermacisë që kishte fituar Lëvizja Nacionalçlirimtare në Shqipëri, pas shtrirjes me forcë të autoritetit të vet në Shqipërinë e Veriut, dhe të kthesës që kishte ndodhur në qëndrimin e aleatëve perëndimorë ndaj forcave fituese në vend. Por, as Balli Kombëtar nuk u shpreh në favor të Zogut, ndonëse ka paraqitur ankesa e memorandume tek qeveritë amerikane e britanike në mbarim të luftës. Zyrtarisht, brenda vendit, vetëm “Lëvizja e Legalitetit” e mbështeti idenë e krijimit të një qeverie shqiptare në emigracion me Zogun në krye. Për këtë qëllim ajo u dërgoi në maj 1944 një promemorje të veçantë qeverive të SHBA dhe Britanisë së Madhe dhe një letër të posaçme edhe Fan Nolit.<sup>48</sup> Jashtë vendit edhe në verën e vitit 1944, ideja e një qeverie nën Zogun dhe kërkesa për pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara do të vazhdonin të artikuloreshin në rrethet e emigracionit shqiptar dhe të Shoqërisë së Miqve Amerikanë të Shqipërisë<sup>49</sup>.

<sup>45</sup> TNA, FO 371/33109, p. 117.

<sup>46</sup> FRUS, Sekretari i Shtetit për konsullin e Përgjithshëm në Napoli (Brandt), Washington, më 20 korrik 1944.

<sup>47</sup> Po aty, p.279, Vinant – ambasador në Mbretërinë e Bashkuar për Sekretarin e Shtetit, 19 shtator 1944.

<sup>48</sup> Po aty, RG 226, Promemorje e Lëvizjes së Legalitetit drejtuar qeverive të Britanisë së Madhe dhe SHBA, Tiranë, më 18 maj 1944.

<sup>49</sup> Po aty, RG 226, 875.01/6-1644, Chicago, 6 qershor 1944.

## **2. Raportet e “Vatrës” dhe “Shqipërisë së Lirë” me çështjen shqiptare në vitet 1944-1946**

Tërheqja e mbështetjes së “Vatrës” dhe Nolit ndaj idesë për krijimin dhe njohjen nga Aleatët të një qeverie të kryesuar nga Zogu në emigracion, do të ndodhte në muajt qershor<sup>50</sup> apo shtator 1944<sup>51</sup>. Rritja e forcimi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare, dhe shndërrimi i saj në të vetmin faktor me peshë në Shqipëri pas eliminimit të forcave të tjera politike e ushtarake brenda vendit, u reflektuan edhe në politikën e aleatëve anglezë e amerikanë. Për të mos lejuar rënien e plotë të Shqipërisë në orbitën e Bashkimit Sovjetik, anglezët dhe amerikanët bënë përpjekje ta orientojnë Shqipërinë drejt Demokracive Perëndimore. Për këtë qëllim ata e kaluan mbështetjen vetëm për Frontin Nacionalçlirimtar, duke u përpjekur ta modifikonin atë nga brenda. Si rezultat, faktori Zog në planet e ardhshme të aleatëve anglezë dhe amerikanë u la mënjanë, por nuk u braktis tërësisht, duke u lënë si kartë rezervë për të papriturat që mund të sillnin zhvillimet e ardhshme.

“Vatra” dhe “Shqipëria e Lirë” i dhanë mbështetje të plotë FNÇL, duke u kërkuar qeverive aleate të njihnin Komitetin Antifashist si qeveri e përkohshme, të Shqipërisë dhe pas saj qeverinë e dalë nga Mbledhja e Beratit; kërkuan që Shqipëria të pranohej në Kombet e Bashkuara, në Këshillin e UNRRA-s, të përfitonte nga dëmshpërblimet e luftës dhe ndihmat aleate dhe, sidomos u treguan mjaft aktivë dhe të qëndrueshme për të kundërshtuar politikën greke për cenimin e territoreve të Shqipërisë së Jugut. Kthesa e “Vatrës” nuk u prit mirë nga mbështetësit e Zogut. Noli, ndonëse zyrtarisht ishte peshkop i kishës shqiptare në SHBA u përball sërish me kritika, tashmë nga një kah tjetër i emigrantëve shqiptarë.

### *a) Përpjekjet e “Vatrës” dhe “Shqipërisë së Lirë” për njohjen e qeverisë shqiptare dhe pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara*

Në verën e vitit 1944, persona me influencë brenda FNÇL si Koço Tashkoja dhe Omer Nishani, duke shfrytëzuar njohjet individuale u

<sup>50</sup> Nasho Jorgaqi, *Jeta e Fan Nolit*, Tiranë: “OMBRA GVG”, 2005, f. 225-226.

<sup>51</sup> NARA, Roll 2, 1945-1949, 22 nëntor 1946. (See: Foreign Nationality Groups in the United States, A Handbook-Revised Edition-February 1945), p.7; *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A.V.1952, Letër e Tajar Zavalanit drejtuar Antony Eden, më 30 tetor 1944.

munduan të siguronin mbështetjen e “Vatrës” dhe të “Shqipërisë së Lirë”.<sup>52</sup> Delegacioni i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, pranë Shtabit Aleat në Bari (Itali), më 10 gusht 1944 u drejtoi një letër redaksive (drejtorive) të gazetave “Liria” e “Dielli”, duke i vënë në dijeni për vendimet e Kongresit të Përmetit, të shoqëruar me kërkesën për njohjen e tyre. Përmes letrës u bëhej thirrje “gjithë simpatizantëve të Zogut që dëshirojnë të luftojnë ose të ndihmojnë sinqerisht në çlirimin e popullit tonë dhe që pranojnë të mos shtrojnë në tryezën e bisedimit çështjen e regjimit të nesërm të popullit shqiptar, mund dhe duhet të marrin pjesë në këtë Front”.<sup>53</sup> Nga përmbajtja e letrës duket qartë se deri në këtë kohë kishin munguar lidhjet direkte ndërmjet FNÇL dhe emigracionit shqiptar në SHBA.

Qerim Panariti dhe Konstandin Çekrezi më 8 tetor 1944, në emër të “Vatrës” dhe të “Shqipërisë së Lirë”, si dhe në emër të Komitetit Shqiptaro-Amerikan, vizituan Departamentin e Shtetit, duke kërkuar njohjen e FNÇL dhe të qeverisë së dalë nga Kongresi i Përmetit.<sup>54</sup> Huston, në emër të DSH u përgjigj se politika amerikane nuk mund t’i jepte njohje në këtë periudhë asnjë grupi politik në Shqipëri, sepse do të ishte ndërhyrje në punët e brendshme të vetë shqiptarëve. Tajar Zavalani, në emër të Komitetit “Shqipëria e Lirë”, që ishte mbledhur në Boston më 17 shtator 1944 i drejtoi një letër nga Londra Antony Eden, që të njihte qeverinë provizore të krijuar në Përmet dhe t’i jepej Shqipërisë statusi i një vendi anëtar në Kombet e Bashkuara.<sup>55</sup> Kjo kërkesë u theksua sërish nga Çekrezi në telegramet drejtuar Edward Stettinius<sup>56</sup> dhe presidentit Franklin D. Roosevelt në nëntor 1944. Më 2 dhjetor një kërkesë e ngjashme iu përcoll sekretarit të Shtetit nga shumica e organizatave të emigracionit shqiptar në SHBA, duke përfshirë edhe Kishën Ortodokse Shqiptare në SHBA.<sup>57</sup> “Dielli” do të fillonte të botonte artikuj për zhvillimet në Shqipëri. Më 29 nëntor 1944, Noli i dërgoi presidentit Rusvelt një telegram, përmes të cilit kërkonte që Shqipëria të pranohej në

<sup>52</sup> N. Jorgaqi, *Jeta e Fan Nolit...*, f. 226-227.

<sup>53</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi (më tej: F.) 41, Viti (më tej: V.) 1944, Dosja (më tej: D.) 154, Thirrje e delegacionit të Shtabit të UNÇ drejtuar gazetave “Liria” dhe “Dielli”, Bari, gusht 1944, f. 3.

<sup>54</sup> *NARA*, RG 226, 875.01/10-744, 7 tetor 1944.

<sup>55</sup> *AIH*, A.V. 152, f. 12.

<sup>56</sup> *NARA*, RG 226, 875.01/12144.

<sup>57</sup> *Po aty*, RG 226, 3 dhjetor 1944.

Kombet e Bashkuara, duke e parë këtë hap si një lloj garancie për zgjidhjen pozitive të çështjes së pavarësisë dhe ruajtjes së integritetit tokësor të Shqipërisë. Telegramet të njëjta iu dërguan edhe Çurçillit e Stalinit.<sup>58</sup> “Vatra” dhe Noli ishin shumë të interesuar që të rivendoseshin sa më shpejt marrëdhëniet diplomatike me qeverinë e SHBA, e cila do të ndikonte pozitivisht në zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare të vendit dhe në riaktivizimin e lidhjeve të shqiptaro-amerikanëve me familjarët e tyre në Shqipëri.

Kthesa e “Vatrës” nuk u prit mirë nga mbështetësit e Zogut në SHBA, një grup prej të cilëve u ankuan për politikën e Nolit dhe të “Vatrës” tek Zyra Informativ e Luftës.<sup>59</sup> Ata kërkuan shpjegime për politikën amerikane të mosnjohjes së një qeverie të kryesuar nga Zogu, duke këmbëngulur në njohjen e saj.

Drejtuesit e “Vatrës” u munduan të kapërcenin ngërçin e shkaktuar nga qëndrimi i qeverisë shqiptare, e cila refuzonte të njihte të gjitha marrëveshjet dhe traktatet që kishin ekzistuar ndërmjet dy vendeve në periudhën e para pushtimit të Shqipërisë nga Italia e Musolinit, duke përdorur si referencë Kongresin e Përmetit. Noli, Qerim Panariti dhe drejtues të tjerë të saj u munduan të ndikonin në arritjen e mirëkuptimit, si tek qeveria amerikane ashtu edhe tek qeveria shqiptare. Përpjekjet dhe këshillat e tyre nuk qenë të suksesshme, sepse për qeverinë amerikane kushti i vënë ishte çështje parimore e zbatuar edhe me vendet e tjera. Noli pati disa takime në DASH për problemin shqiptar. Më 21 mars 1946 Noli, Dr. Telford C. Erickson (ish mësues amerikan në Shqipëri) dhe Peter Kolonja ish përfaqësuesi personal i Mbretit Zog në SHBA, zhvilluan një takim me zyrtarë të DASH, duke shprehur shqetësimin e tyre për mosvendosjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet të dy vendeve dhe shpresën e komunitetit të shqiptarëve në SHBA për përmirësimin e situatës<sup>60</sup>. Të tre kërkuan të dinin diçka më shumë se, përse DASH këmbëngulte kaq shumë për njohjen e traktateve dhe marrëveshjeve të lartpërmendura. Por diplomati amerikan e konsideronte atë procedurë normale, sepse këto instrumente siguronin bazat e domosdoshme të marrëdhënieve ndërkombëtare. Të tre kërkuan që, si më parë, SHBA ta trajtonte me simpati çështjen shqiptare, duke përfshirë

<sup>58</sup> N. Jorgaqi, *Jeta e Fan S. Nolit...*, f. 230.

<sup>59</sup> NARA, RG.226, Detrid, Michigan, 31 tetor 1944.

<sup>60</sup> NARA, RG 59, File 711.75, Memorandum bisedimi, 21 mars 1946, pp.1-3.

edhe pranimin e saj në Kombet e Bashkuara. Noli kërkoi të zhvillonte një takim të ardhshëm me Sekretarin Amerikan të Shtetit me qëllim që t'i përcillte atij mendimet e komunitetit shqiptar në SHBA<sup>61</sup>.

Opinionet e zyrtarëve amerikanë dhe të tijat, Noli do t'ia përcillte Enver Hoxhës, ndonëse jo gjithnjë përmes komunikimit direkt me të, duke i bërë të ditur se njohja e traktateve ishte një "konditë e domosdoshme për njohjen e qeverisë shqiptare. "Ky pranim, - theksonte Noli, - do të sjellë automatikisht njohjen amerikane, do të zhdukë pengesat për pranimin në UNO dhe do të na lehtësojë punën e mbrojtjes me sukses të integritetit tokësor të Shqipërisë"<sup>62</sup>. Mosnjohja e marrëveshjeve ndikonte negativisht edhe në pranimin e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara. Në prill 1946, Noli e këshilloi kryeministrin e Shqipërisë që të dërgonte një delegacion pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në New York, që të jepte shpjegimet e nevojshme për kërkesën e Shqipërisë, e cila do të diskutohej në Këshillin e Sigurimit. Noli ka pasur një komunikim intensiv me Hoxhën në periudhën mars-gusht 1946. Ndërmjet të tjerave ai i sugjeroi këtij të fundit, që në delegacionin shqiptar që do të merrte pjesë në konferencën ndërkombëtare të shëndetësisë të përfshihej edhe Koço Tashkoja, si person i familjarizuar me New York-un, si ish kryekonsull i Shqipërisë. Por edhe kjo kërkesë e tij nuk u plotësua. Duket se Noli e kishte humbur durimin me qeverinë komuniste dhe përfaqësuesit e saj në Amerikë. "U lodha duke ju përsëritur, - i shkruante ai Enver Hoxhës më 30 shtator 1946, - që duhet t'i pranoni traktatet në parim, pa kondita, se fundi i fundit kjo tani është vetëm një çështje formale pa rëndësi praktike"<sup>63</sup>. Ndërsa sekretari dhe botuesi i "Vatrës", Qerim Panariti do t'ia shkruante Koço Tashkos një muaj më vonë se mospranimi i traktateve me Amerikën ishte një marrëzi e dorës së parë dhe se qëndrimi i qeverisë shqiptare kishte sjellë pemët e hidhura në United Nations (Kombet e Bashkuara).<sup>64</sup> Enver Hoxha, përmes një mesazhi, do t'ia bënte të ditur Fan Nolit se "Kondita e njohjes së qeverisë sonë e vënë nga qeveria e SHBA

<sup>61</sup> *Po aty*.

<sup>62</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), V. 1946, D. 61, Telegram i F.S.Nolit drejtuar MPJ për Enver Hoxhën, më 25. 03.1946.

<sup>63</sup> *Po aty*, V. 1946, D. 61, f. 68.

<sup>64</sup> B. Meta, *Tensioni greko-shqiptar...*, f.112, Letër e Qerim Panaritit drejtuar Koço Tashkos, 14 tetor 1946.

na ka habitur dhe hidhëruar, pse këtë e konsiderojmë, si një mohim të sovranitetit dhe vetëvendosjes të popullit tonë, për të cilat populli shqiptar derdhi kaq gjak. Vendimet e Kongresit të Përmetit të bazuar në këto principe na urdhërojnë prishjen e të gjitha traktateve të konkluduara me shtetet e huaja nga qeveritë e mëparshme antipopullore”.<sup>65</sup> Në të vërtetë, vetëm 3 vjet më pas në vitin 1949, në kërkim të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me SHBA, Enver Hoxha e Manush Myftiu do të udhëzonin Behar Shtyllën, se në rast se amerikanët do dëshironin të vendosnin marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, mund t’u ofrohej njohja e plotë e të gjithë traktateve, sepse ato nuk kishin ndonjë rëndësi të madhe. Njohja e dokumentacionit arkivor shqiptar gjatë viteve të fundit të krijon bindjen së mosnjohja e traktateve dypalëshe dhe sidomos ai i ‘kombit të favorizuar’ ishin edhe vepër e jugosllavëve dhe sovjetikëve<sup>66</sup>. Këta të fundit e këshilluan qeverinë shqiptare që të mos i njihte të gjitha traktatet dhe marrëveshjet ndërmjet dy vendeve, por vetëm një pjesë të tyre, duke lënë mënjanë sidomos traktatin që i njihte SHBA si “komb të favorizuar”. Qeveria jugosllave nga ana e vet, që në muajin mars 1946 i kishte njohur të gjitha traktatet dhe marrëveshjet e paraluftës me SHBA, gjë që i parapriu vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve<sup>67</sup>.

*b) Reagime ndaj kërkesave greke për Shqipërinë e Jugut*

Kërkesat greke për Shqipërinë e Jugut, si kemi përmendur në këtë artikull kishin sjellë shqetësime të vazhdueshme për “Vatrën” dhe “Shqipërinë e Lirë”, që nga koha e artikulimit të tyre gjatë luftës, por ato ishin bërë veçanërisht kërcënuese në prag të mbajtjes së Konferencës së Paqes së Parisit. Shqipëria kishte dy disavantazhe të forta ndaj qeverisë greke, sepse ajo nuk ishte e njohur nga SHBA dhe Britania e Madhe dhe nuk ishte vend anëtar i Kombeve të Bashkuara. Shqipëria shkonte në Konferencën e Paqes me një status të lëkundur, moralisht ndjehej vend aleat, por zyrtarisht ajo nuk ishte e tillë.

Që në nëntor 1944, sekretari në detyrë i DSH, Stettinius, i bënte të ditur këshilltarit politik në Kazerta pikëpamjen e tij për kufirin shqiptaro-

<sup>65</sup> AMPJ, V. 1946, D. 61, f. 70.

<sup>66</sup> Hamit Kaba, “Dështimi i përpjekjeve të qeverisë shqiptare për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA (1944-1946)”, *Studime historike*, 3-4, Tiranë: 2005, f.108-111.

<sup>67</sup> Po aty, f. 109.

grek dhe ndaj palëve në konflikt. Sipas tij, diskutimet mbi kufijtë nuk mund të vendoseshin pa u bërë më parë rregullimet e përgjithshme. Por, deri atëherë, kufijtë e paraluftës duhej të konsideroheshin si kufij legalë, ndërsa pretendimeve greke mund t'u jepej mundësi dëgjimi<sup>68</sup>. Reagimet e “Vatrës”, “Shqipërisë së Lirë” dhe degëve të tyre në SHBA për këtë çështje kanë qenë të forta dhe të vazhdueshme. Mosnjohja e qeverisë shqiptare nga SHBA dhe Britania e Madhe, dy ish aleatët e mëdhenj përëndimorë të luftës, rezoluta e senatorit Pepper, mosthirrja në Konferencën e San Franciskos dhe as në fillimet e punimeve të Konferencës së Paqes të Parisit e kishin shtuar shqetësimin e komunitetit shqiptar të Amerikës.

Pa dyshim një ngjarje që do ta acaronte më tej situatën ishte miratimi nga Komiteti për Marrëdhëniet me Jashtë i Senatit të Shteteve të Bashkuara i rezolutës së senatorit Pepper për “Epirin e Veriut”<sup>69</sup>. Sipas kësaj rezolute një pjesë e territorit të Shqipërisë së Jugut, duke përfshirë edhe qytetin e Korçës do t'i kalonin Greqisë. Situatën do ta tensiononte më tej shkuarja në Amerikë e peshkopit Pandeleimon Kotoko, i cili do të agjitonte në favor të aneksimit të territoreve shqiptare nga Greqia. Shqiptarët e Amerikës reagues me forcë ndaj këtij rreziku. Më 29 mars 1946, Fred Kosta si kryetar i Komitetit për Mbrojtjen e Integritetit të Territoreve Shqiptare, të Lidhjes Progresive Shqiptaro-Amerikane dhe të degës 21 të Federatës Panshqiptare të Amerikës do t'i drejtonin një telegram Presidentit Amerikan, duke protestuar për pranimin e Kotokos në Amerikë dhe mungesës së dhënies të të njëjtit shans përfaqësimi për Shqipërinë<sup>70</sup>. Presidentit amerikan i bëhej e ditur se marrja e një vendimi për copëtimin e territorit shqiptar do të rezultonte në një gjakderdhje, sikurse kishte ndodhur në vitet 1914-1915. Që drejtësia të vihej në vend, kërkohet që të ftohej të shkonte në SHBA një përfaqësues nga Shqipëria, i cili do të merrej me mbrojtjen e vendit të vet. Telegrami sqaronte se Pandeleimon Kotoko nuk ishte grek nga origjina. Përkundrazi, prindërit e tij ishin nga Korça dhe nuk flisnin tjetër gjuhë veç shqipes. Edhe vetë peshkopi Kotoko ishte i lindur në Korçë. Gjithashtu ai akuzohej se gjatë LDB ai kishte qenë kolaboracionist, dhe si i tillë duhej dënuar si tradhtar

<sup>68</sup> *FRUS*, Vol. III, p. 285, Sekretari në Detyrë i Shtetit për zotin Aleksandër C. Kirk – këshilltar Politik në Shtabin e Forcave Aleate në Kazerta, 9 nëntor 1944.

<sup>69</sup> *AMPJ*, V. 1946, D. 47, fl. 6.

<sup>70</sup> *NARA*, Roll 2, 1945-1949, 875.00.

nga populli shqiptar. Telegrami theksonte rolin e veçantë që kishin pasur patriotët korçarë për pavarësinë e Shqipërisë, si dhe përbërjen etnike shqiptare të qytetit të Korçës<sup>71</sup>. Në përgjigjen e dhënë për këtë çështje, nga Departamenti i Shtetit më 27 maj 1946 bëhej e ditur se, peshkopi grek nuk ishte ftuar zyrtarisht nga qeveria amerikane, por ishte një person privat që paraqiste pikëpamjen e tij për çështjen e kufijve greko-shqiptarë, dhe se nuk kishte bazë ligjore kërkesa për ta ndaluar atë që të vizitonte SHBA. Nga ana tjetër SHBA nuk mund të ftonin ndonjë përfaqësues të qeverisë shqiptare dhe as ndonjë person privat në Amerikë sepse ndërmjet të dy vendeve nuk kishte marrëdhënie diplomatike.<sup>72</sup>

Rezoluta e senatorit Pepper solli reagimin jo vetëm të shqiptaro-amerikanëve por edhe të miqve të Shqipërisë. Ish ambasadori amerikan në Shqipëri, Çarls Hart botoi një artikull të posaçëm në gazetën “Washington Post”. “Rektifikimet e vogla në Shqipëri, shkruante ai, kanë për qëllim t’i vjedhin këtij vendi një të katërtën e popullsisë dhe një të pestën e tokës së saj”.<sup>73</sup> Duke vlerësuar kontributin e ish ambasadorit amerikan në Shqipëri, Fan Noli dhe Vasil Pani i dërguan një letër Enver Hoxhës, për të lejuar ardhjen në Shqipëri të Çarls Hart<sup>74</sup>, por kjo letër mbeti pa përgjigje. Protestës së Enver Hoxhës për këtë rezolutë do t’i përgjigjej përmes një memorandumit të posaçëm në emër të qeverisë amerikane, shefi i Misionit Civil të SHBA në Shqipëri, Joseph Jacobs (Jozef Jakobs), i cili do të theksonte se ajo nuk paraqiste qëndrimin e degës ekzekutive, pra të qeverisë amerikane dhe si e tillë ajo nuk kishte fuqi zbatuese. Shqetësimi i komunitetit shqiptaro-amerikan ka qenë konstant jo vetëm në këtë segment kohor, që trajtuam më sipër, por gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë.

Largimi i misionit amerikan nga Shqipëria në nëntor 1946, pa arritur të vendosë marrëdhëniet diplomatike me vendin tonë; fillimi i Luftës së Ftohtë dhe ekzistenca e një regjimi komunist në Shqipëri, larg vizionit të shqiptaro-amerikanëve dhe demokracisë amerikane u reflektuan edhe në marrëdhëniet e “Vatrës” me qeverinë shqiptare. Organizata “Shqipëria e Lirë” ishte më afër qeverisë komuniste të Tiranës dhe u mbështet edhe financiarisht prej saj. Në ftohjen e marrëdhënieve të “Vatrës” me

<sup>71</sup> *Po aty*.

<sup>72</sup> *Po aty*, Roll 2, 1945-1949, 875.00, 27 maj 1945.

<sup>73</sup> *AMPJ*, V. 1944, D. 30, fl. 30-34.

<sup>74</sup> *NARA*, Roll 4, 1945-1949, 875.00.

qeverinë shqiptare, përveç faktorëve të lartpërmendur duhet edhe roli i emigracionit të ri politik, të mbërritur në SHBA pas Luftës së Dytë Botërore. Duhet përmendur se emigracioni i ri që erdhi në Amerikë në vitet e Pasluftës së Dytë Botërore, në dallim nga paralufta, ishte në përgjithësi i një kalibri tjetër, me formim të suksesshëm arsimor e profesional<sup>75</sup>. Një pjesë e rëndësishme e tij kishte qenë e përfshirë në jetën politike të vendit, të tjerë kishin qenë të implikuar me Fuqitë e Boshtit. Emigracioni kishte si karakteristikë antikomunizmin e deklaruar, dhe i përkiste spektrave të ndryshëm politikë, me përjashtim të ekstremist të majtë. Nga pikëpamja gjeografike emigracioni i ri vinte jo vetëm nga jugu, por edhe nga Shqipëria e Mesme dhe e Veriut. Ky kolor, do të forcohej më tej me ardhjen e shqiptarëve të tjerë nga Mali i Zi, Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi, duke filluar nga vitet 60 e më pas. Emigracioni politik shqiptar i mbërritur në SHBA kryesisht duke filluar nga viti 1948 u kundërshtua nga “Vatra”, e cila nuk i pranonte në radhët e saj. Mosmarrëveshjet dhe kundërshtitë janë shprehur sidomos në publikimet e secilës palë. Por me kalimin e kohës, emigrantët ekonomikë të përqendruar tek “Vatra” dhe ata politikë tek “Komiteti Shqipëria e Lirë” filluan të afrohen gradualisht, por pa u shkruar me njeri-tjetrin.

Emigracioni i ri i Pasluftës e fitoi me vështirësi integrimin e tij në organizatën kryesore të komunitetit shqiptar në Amerikë, “Vatrën”. Por, në shtatorin e vitit 1958, në statutin e “Vatrës” u miratua një nen, sipas të cilit, “mund të pranoheshin te “Vatra”, të gjithë bijtë e racës shqiptare”<sup>76</sup>. Kjo klauzolë u hapi rrugën e pranimit edhe shqiptarëve të arratisur nga Shqipëria pas Luftës së Dytë Botërore. Një tjetër klauzolë e po këtij statuti përcaktonte se ““Vatra” nuk duhet të ketë marrëdhënie me ato shtete, me të cilat SHBA nuk kanë marrëdhënie diplomatike”<sup>77</sup>. Si rrjedhojë, marrëdhëniet institucionale të “Vatrës” me regjimin komunist në Shqipëri konsideroheshin jo të pranueshme. Në fakt, marrëdhëniet ishin ftohur më herët. Nuk ishte më “Vatra”, por “Shqipëria e Lirë”, organizata e preferuar e qeverisë së Tiranës. Kishte kohë që “Dielli” ishte

<sup>75</sup> Stephen Peters, “Characteristics, contributions and responsibilities of Albanian-Americans”, *International Seminar of Pan-Albanian Federation “VATRA”*, New York: 28-29-30 nëntor 1969, p. 89.

<sup>76</sup> AMPJ, V. 1959, D. 522, Relacion i përfaqësuesit të përhershëm të Shqipërisë pranë Kombeve të Bashkuara, Reiz Malile “Mbi kollonin shqiptare në SHBA”, New York, më 22 janar 1959, f.45.

<sup>77</sup> *Po aty*.

bërë kritik ndaj regjimit komunist shqiptar, përmes artikujve të botuar për situatën në Shqipëri, për politikën e brendshme dhe të jashtme të qeverisë shqiptare dhe veçanërisht për qëndrimin e saj ndaj SHBA. Qeveria shqiptare fajësonte për këto qëndrime jo vetëm Qamil Panaritin, si botues i “Vatrës”, por edhe Fan Nolin, si drejtues real i saj. Megjithë kritikën reciproke ndërmjet emigracionit të vjetër e të ri në SHBA, duhet të përmendim se roli i Fan Nolit dhe autoriteti i tij tek shqiptarët e Amerikës, vazhdoi të vlerësohej edhe nga krerët e emigracionit politik shqiptar. Në vitet e mëvonshme marrëdhëniet e “Vatrës” me qeverinë shqiptare pothuajse u ndërpre. U ruajtën vetëm disa kontakte me persona të veçantë të emigracionit shqiptar në SHBA, përmes përfaqësuesve të Shqipërisë pranë Kombeve të Bashkuara në New York dhe kjo gjendje vazhdoi deri në rënien e regjimit komunist në Shqipëri.

### *S u m m a r y*

#### “VATRA” AND “SHQIPERIA E LIRE” IN TWO CRUCIAL PERIODS 1941-1946

The paper “Vatra” (The Hearth) and “Shqipëria e Lire” (Free Albania) in two crucial periods, 1941-1946 deals with the political activity of these two organizations of Albanian emigrants in the US in support of their mother country, Albania. The paper is based primarily on American, British and Albanian documentary sources, as well as on publications on these two organizations. The aim is to highlight the attitude of these two organizations during the WWII, 1941-1944 and after the war, 1944-1946, with regard to the Albanian question. The paper analyses the contradictions between the two organizations related to the recognition of an Albanian government in exile, led by Zogu; their attempts in support of the Atlantic Charter and the joining of Albania in the Charter of the United Nations, the recognition of the National Liberation Front's government by the Anglo-American allies, the organization of the Albanian circles against the Greek claims in south Albania, the admission of Albania in the United Nations, etc. Apart from their differences these two organizations of Albanians in America had in common the patriotic objective to support Albania and were considered at the time the real voice of Albanians across the Atlantic.

